

16.03.2026. Prishtinë

Për: Kuvendin e Federatës së Basketbollit të Kosovës**Nga:** Arben Fetahu, Kryetar, FBK**Lënda:** Raport i Punës për vitin 2025

I. HYRJE EKZEKUTIVE

Viti 2025 përfaqëson një vit kyç për Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), si viti i fundit i zbatimit të Planit Strategjik 2021–2025 dhe njëkohësisht vit tranzicioni drejt hartimit dhe miratimit të Strategjisë së re 2026–2030. Gjatë këtij viti, FBK ka qenë e fokusuar në përmbylljen e objektivave strategjike, forcimin e qeverisjes institucionale, rritjen e prezencës ndërkombëtare dhe krijimin e bazës për zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë.

Në këtë kontekst, roli i Sekretares së Përgjithshme ka qenë i orientuar drejt:

- udhëheqjes së procesit të zbatimit strategjik;
- koordinimit të projekteve zhvillimore dhe ndërkombëtare;
- forcimit të kapaciteteve institucionale;
- përfaqësimit të FBK-së në strukturat e FIBA-s, FIBA Europe, KOK, MKRS etj
- mbështetjes profesionale të Bordit në proceset e vendimmarrjes.

Ky raport paraqet një pasqyrë të përmbledhur dhe analitike të punës së realizuar gjatë vitit 2025, me fokus në aktivitetet, projektet dhe proceset me ndikimin më të madh institucional dhe strategjik.

II. AKTIVITETET STRATEGJIKE KRYESORE GJATË VITIT 2025

1. Projekte zhvillimore, komunikim institucional dhe inovacion

Gjatë vitit 2025, përveç projekteve zhvillimore dhe partneriteteve ndërkombëtare, FBK ka iniciuar dhe zhvilluar platforma të reja strategjike që synojnë modernizimin e komunikimit institucional, rritjen e transparencës dhe angazhimin e komunitetit të basketbollit.

Podcasti i FBK-së është konceptuar si një platformë e re e komunikimit institucional, me qëllim krijimin e një hapësire të rregullt dialogu me aktorët kryesorë të basketbollit kosovar (klube, sportistë, trajnerë, drejtues dhe partnerë). Kjo platformë synon të kontribuojë në rritjen e transparencës, forcimin e dialogut dhe promovimin e temave strategjike të basketbollit dhe do të shërbejë si mjet afatgjatë komunikimi në periudhën 2026–2030.

Në kuadër të transformimit institucional dhe ripozicionimit të imazhit të Federatës, gjatë vitit 2025 është zhvilluar gjithashtu koncepti “Basketbolli 3.0”, si një platformë strategjike që synon modernizimin e identitetit të basketbollit kosovar përmes inovacionit, përfshirjes dhe angazhimit të

ELVIRA DUSHKU**Sekretare e Përgjithshme****Federata e Basketbollit të Kosovës**

komunitetit. Basketbolli 3.0 përfaqëson një qasje të re ndaj komunikimit, ndërveprimit me publikun dhe zhvillimit të iniciativave të reja promovuese dhe zhvillimore, duke krijuar bazë për implementim të mëtejshëm në ciklin strategjik 2026–2030.

2. Organizime ndërkombëtare dhe diplomaci sportive

Indikatorë kyç (KPI):

- 5 ngjarje madhore ndërkombëtare të FIBA/FIBA Europe të organizuara në Kosovë
- 0 ndëshkime organizative/vlerësim pozitiv nga FIBA
- Rritje e besimit institucional për organizime të ardhshme (2026–2027)

Gjatë vitit 2025, FBK ka forcuar ndjeshëm pozitën e saj në arenën ndërkombëtare përmes organizimit të suksesshëm të disa ngjarjeve madhore të FIBA-s dhe FIBA Europe, duke dëshmuar kapacitetet të lartë organizativ dhe besueshmëri institucionale.

Ngjarjet kryesore të organizuara përfshijnë:

- FIBA U16 Women's EuroBasket, Divizioni C;
- FIBA 3x3 Europe Cup Qualifiers;
- FIBA Europe U14 Get-Together;
- Takimin e Komisionit të të Rinjve të FIBA Europe;
- FIBA 3x3 Challenger Prishtina (në bashkëpunim me klubin 3x3 Prishtina dhe MKRS).

Këto organizime kanë kontribuar drejtpërdrejt në:

- rritjen e reputacionit ndërkombëtar të Kosovës;

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2025, Federata e Basketbollit e Kosovës ka pritur në vizitë zyrtare krerët më të lartë të FIBA Europe, përkatësisht Presidentin e FIBA Europe, Jorge Garbajosa dhe Drejtorin Ekzekutiv, Kamil Novak. Kjo vizitë përbën një vlerësim të drejtpërdrejtë të progresit institucional të FBK-së, kapaciteteve organizative dhe rolit gjithnjë e më aktiv të Kosovës në strukturat e basketbollit evropian.

- *zhvillimin e diplomacisë sportive;*
- *avancimin e stafit organizativ të FBK-së;*
- *krijimin e parakushteve për organizime edhe më të avancuara në të ardhmen.*

ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

3. Përfaqësueset e Kosovës dhe performanca sportive

Indikatorë kyç (KPI):

- 8 përfaqësuese aktive në gara zyrtare ndërkombëtare
- Rezultat historik: U20 Meshkujt – vendi i 8-të në Evropë (Div. B)
- 100% pjesëmarrje e grupmoshave U16–U20 në ciklin evropian

Gjatë vitit 2025, Kosova është përfaqësuar me tetë (8) Përfaqësuese Kombëtare në gara zyrtare ndërkombëtare, duke përfshirë të gjitha grupmoshat.

Theksohen në veçanti:

- Përfaqësuesja A e Meshkujve në para-kualifikimet për FIBA EuroBasket 2029;
- Rezultati historik i Kosovës U20 (Meshkujt), renditja e 8-të në Kampionatin Evropian, Divizioni B – suksesi më i madh në kategoritë e reja që nga pranimi në FIBA;
- Pjesëmarrja aktive e përfaqësueseve U16–U18 në kampionate evropiane;
- Aktivizimi i grupmoshave U14 në kuadër të projekteve zhvillimore të FIBA Europe.

Këto rezultate janë reflektim i investimit të vazhdueshëm në zhvillimin e të rinjve, edukimin e trajnerëve dhe strukturimin e sistemit të përfaqësueseve.

4. Zhvillimi i basketbollit për vajza dhe gra

Indikatorë kyç (KPI):

- 1 Kampionat Evropian për vajza i organizuar në Kosovë
- 1 klub kosovar për herë të parë në FIBA EuroCup Women
- +150 vajza të përfshira në aktivitete grassroots (Her World, Her Rules)
- Prioritet strategjik i konfirmuar për ciklin 2026–2030

Zhvillimi i basketbollit për vajza dhe gra ka mbetur një prioritet strategjik edhe gjatë vitit 2025.

Arritjet kryesore përfshijnë:

- Organizimin e FIBA U16 Women's EuroBasket, Divizioni C;
- Pjesëmarrjen historike të KBF Peja 03 në FIBA EuroCup Women;
- Zbatimin e projekteve FIBA Europe "Her World, Her Rules" dhe aktiviteteve të dedikuara për vajzat;
- Rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në programet grassroots dhe kategoritë e reja.

Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e dukshmërisë, përfshirjes dhe fuqizimit të basketbollit femëror, duke krijuar bazë të qëndrueshme për hartimin e një strategjie të veçantë për basketbollin e vajzave dhe grave në periudhën e ardhshme.

ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës

Në këtë kontekst, FBK ka qenë gjithashtu pjesë e projektit Erasmus+ Sport PROMISE, i cili ka synuar forcimin e përfshirjes së vajzave dhe grave në basketboll dhe integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe programet e Federatës.

5. Projekte zhvillimore dhe partneritete ndërkombëtare

Indikatorë kyç (KPI):

- 6 projekte aktive ndërkombëtare (FIBA / Erasmus+)
- 3 fusha reformash: safeguarding (politika e mbrojtjes), digjitalizimi, grassroots (basketbolli bazë)
- Rritje e kapaciteteve të stafit dhe partneriteteve evropiane

Gjatë vitit 2025, FBK ka zbatuar një numër të konsiderueshëm projektsh zhvillimore në bashkëpunim me FIBA, FIBA Europe, MKRS dhe partnerë evropianë.

Projektet kryesore përfshijnë:

- *Safeguarding the Future (Erasmus+);*
- *Shooter – Digitalisation in Basketball (Erasmus+);*
- *FIBA Europe Youth Development Fund (FIBA Europe)*
- *Alley Oop (FIBA Europe);*
- *Sport në Shkolla 3x3 (në bashkëpunim me MKRS);*
- *Junior NBA Kosova (NBA)*
- *FIBA Europe Girls Programme*

Këto projekte kanë ndikuar në:

- *rritjen e kapaciteteve institucionale;*
- *përmirësimin e qeverisjes dhe politikave mbrojtëse;*
- *masivizimin e basketbollit;*
- *digjitalizimin e proceseve;*
- *forcimin e rolit social të sportit.*
- *Rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në programet grassroots dhe kategoritë e reja.*

ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës

III. PËRMBLEDHJE E ZBATIMIT TË PLANIT STRATEGJIK 2021–2025

Plani Strategjik 2021–2025 ka qenë plani i parë gjithëpërfshirës strategjik i FBK-së dhe ka shërbyer si bazë për profesionalizimin e qeverisjes dhe planifikimit institucional.

Gjatë periudhës së zbatimit janë arritur përparime të rëndësishme në:

- *zhvillimin e kapaciteteve njerëzore;*
- *rritjen e numrit të ngjarjeve ndërkombëtare;*
- *avancimin e basketbollit për vajza dhe gra;*
- *përmirësimin e strukturës organizative;*
- *rritjen e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë.*

Njëkohësisht, janë identifikuar sfida të vazhdueshme në fushën e financave, infrastrukturës dhe angazhimit të klubeve, të cilat kanë shërbyer si mësim të rëndësishme për hartimin e Strategjisë 2026–2030.

IV. RAPORT PËRMBLEDHËS PËR BORDIN – HULUMTIMI STRATEGJIK

Në kuadër të përgatitjeve për Strategjinë 2026–2030, FBK ka realizuar hulumtimin “Pikëpamjet Strategjike të Klubeve dhe të FBK-së”, i cili ka shërbyer si bazë për identifikimin e prioriteteve të ardhshme.

Gjetjet kryesore lidhen me:

- *sfidat financiare dhe varësinë nga sponsorët;*
- *nevojën për reformë të sistemit të garave;*
- *mungesën e ligave tranzitore për të rinjtë;*
- *nevojën për programe të unifikuara për trajnerë dhe gjyqtarë;*
- *fuqizimin e basketbollit për vajza dhe gra;*
- *përmirësimin e infrastrukturës sportive.*

Ky raport ka shërbyer si dokument teknik për mbështetjen e Bordit në procesin e vendimmarrjes strategjike.

V. KONKLUZIONE DHE HAPAT E ARDHSHËM

Viti 2025 shënon përmbylljen e një cikli strategjik dhe hapjen e një faze të re zhvillimore për FBK-në. Bazuar në përvojën e fituar gjatë zbatimit të Planit Strategjik 2021–2025 dhe në analizat e realizuara gjatë vitit 2025, Federata hyn në periudhën 2026–2030 me dy dokumente strategjike komplementare, të ndara qartë sipas fushëveprimit dhe objektivave.

ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës

Viti 2025 ka përmbyllur një cikël të rëndësishëm zhvillimor për FBK-në dhe ka krijuar bazë solide për periudhën e ardhshme strategjike.

Prioritetet kryesore për periudhën 2026–2030 përfshijnë:

- zhvillimin e infrastrukturës;
- fuqizimin e klubeve dhe kategorive të reja;
- rritjen e qëndrueshmërisë financiare;
- avancimin e basketbollit për vajza dhe gra;
- thellimin e bashkëpunimit me FIBA, MKRS dhe partnerë të tjerë strategjikë.

Ky raport synon të shërbejë si dokument orientues për Bordin e FBK-së dhe si bazë për vendimmarrje të informuar në fazën e ardhshme të zhvillimit institucional.

VI. ORIENTIMI STRATEGJIK 2026–2030: DY PLANE KOMPLEMENTARE

Plani Strategjik i përgjithshëm i FBK-së 2026–2030 – Qëllimet kryesore

Plani Strategjik i Përgjithshëm i FBK-së për periudhën 2026–2030 është i ndërtuar mbi pesë (5) qëllime strategjike kryesore, të harmonizuara me prioritetet e FIBA-s dhe nevojat reale të zhvillimit të basketbollit në Kosovë:

1. **Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për edukimin e trajnerëve të FBK-së**
Ndërtimi dhe institucionalizimi i një sistemi të standardizuar të edukimit dhe licencimit të trajnerëve, në përputhje me programet dhe kornizat e FIBA-s, me qëllim rritjen e cilësisë së trajnimit në të gjitha nivelet.
2. **Ndërtimi i një programi të zhvillimit të talenteve**
Krijimi i një programi të strukturuar dhe të qëndrueshëm për identifikimin, zhvillimin dhe tranzicionin e talenteve nga niveli bazë (grassroots) drejt ekipeve kombëtare.
3. **Zgjerimi i komunitetit të basketbollit**
Rritja e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në basketboll përmes programeve grassroots, bashkëpunimit me shkollat dhe universitetet, zhvillimit të basketbollit 3x3 dhe angazhimit të komuniteteve lokale.
4. **Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave**
Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në të gjitha nivelet e basketbollit, si lojtare, trajnere, gjyqtare dhe në role drejtuese, si një prioritet i integruar në të gjitha politikat dhe programet e FBK-së.
5. **Fuqizimi i ekipeve kombëtare**
Përmirësimi i performancës dhe qëndrueshmërisë së ekipeve kombëtare në të gjitha

ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

grupmoshat, përmes strukturave të qarta teknike, programeve zhvillimore dhe mbështetjes së qëndrueshme institucionale.

2. Strategjia e veçantë për Zhvillimin e Basketbollit 3x3 2026–2030 (drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030)

Strategjia për Basketbollin 3x3, 2026–2030 është një dokument strategjik i specializuar, i ndërtuar si përgjigje ndaj potencialit të lartë të disiplinës 3x3 dhe rolit të saj në përgatitjen e Kosovës për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030.

Qëllimet kryesore të Strategjisë 3x3 2026–2030:

- Institucionalizimi i disiplinës 3x3 brenda strukturave të FBK-së;
- Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore (lojtarë, trajnerë, referë dhe menaxherë eventesh);
- Krijimi dhe konsolidimi i Ligës Kombëtare 3x3;
- Organizimi i rregullt i eventeve ndërkombëtare FIBA 3x3 në Kosovë;
- Zhvillimi i infrastrukturës së certifikuar për 3x3;
- Pozicionimi i Kosovës dhe i Prishtinës si qendër rajonale e basketbollit 3x3;
- Sigurimi i trashëgimisë sportive, institucionale dhe komunitare pas vitit 2030.

Kjo strategji funksionon si dokument operacional dhe tematik, i harmonizuar plotësisht me Planin Strategjik të përgjithshëm të FBK-së, duke kontribuar drejtpërdrejt në objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të Federatës.

Përfundim për Bordin e FBK-së

Ekzistenca e dy planeve strategjike të ndara, por të harmonizuara, një plan i përgjithshëm institucional dhe një strategji e specializuar për 3x3, i mundëson FBK-së të menaxhojë zhvillimin e përgjithshëm të basketbollit dhe njëkohësisht të investojë në mënyrë të fokusuar në një disiplinë me potencial të lartë ndërkombëtar dhe trashëgimi afatgjatë.

Këto dy dokumente përbëjnë bazën strategjike mbi të cilën Bordi i FBK-së do të ndërtojë vendimet kyçe gjatë periudhës 2026–2030.

ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës

VII. MESAZHET STRATEGJIKE KYÇE PËR BORDIN/PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky seksion synon të mbështesë diskutimin dhe vendimmarrjen e Bordit të FBK-së dhe përmbledh mesazhet kryesore strategjike që dalin nga Raporti i Punës 2025.

1. Viti 2025 – Përmbyllje strategjike dhe vit tranzicioni

Viti 2025 shënon përmbylljen e Planit Strategjik 2021–2025 dhe njëkohësisht krijon bazën për një fazë të re zhvillimore të Federatës. FBK ka kaluar nga një qasje reaktive drejt një modeli planifikimi strategjik, me cikle të qarta, prioritete të matshme dhe rritje të kapaciteteve institucionale.

2. Pozicionimi ndërkombëtar i FBK-së është forcuar ndjeshëm

Organizimi i suksesshëm i ngjarjeve madhore të FIBA-s dhe FIBA Europe, si dhe vizita e kërreve më të lartë të FIBA Europe gjatë vitit 2025, konfirmojnë FBK-në si federatë partnere të besueshme, me kapacitet organizativ dhe rol në rritje në basketbollin evropian.

3. Investimi në përfaqësuese dhe të rinj po jep rezultate konkrete

Rezultati historik i Kosovës U20 (Meshkujt) në Divizionin B dhe pjesëmarrja e plotë e përfaqësueseve në ciklin evropian dëshmojnë se investimi në zhvillimin e talenteve dhe strukturimin e sistemit të përfaqësueseve është drejtimi i duhur dhe duhet të vazhdojë të mbështetet.

4. Basketbolli për vajza dhe gra, nga projekte drejt prioriteti strategjik

Gjatë vitit 2025, basketbolli për vajza dhe gra ka kaluar nga një qasje me projekte në një prioritet të integruar strategjik. Organizimi i FIBA Kampionatit Evropian U16 për vajza dhe pjesëmarrja historike në FIBA EuroCup Women krijojnë bazë të fortë për zhvillim të mëtejshëm në ciklin 2026–2030.

5. Qeverisja dhe politikat mbrojtëse janë forcuar

Zbatimi i projekteve si “Safeguarding the Future” dhe avancimi i politikave të mbrojtjes kanë forcuar standardet e qeverisjes dhe integritetit institucional, duke e pozicionuar FBK-në në linjë me praktikën më të mira evropiane.

6. Dy plane strategjike për periudhën 2026–2030 – qartësi dhe fokus

FBK hyn në periudhën 2026–2030 me dy dokumente strategjike të harmonizuara:

- Planin Strategjik të përgjithshëm 2026–2030, si kornizë institucionale për zhvillimin e basketbollit;

ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës

- Strategjinë e veçantë për Basketbollin 3x3, si investim i fokusuar drejt Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

Ky model i dyfishtë i planifikimit i mundëson Bordit qartësi në prioritetet strategjike dhe fokus të veçantë në disiplinat me potencial të lartë ndërkombëtar.

7. Çështje kyçe për vendimmarrje nga Bordi (2026–2030)

Në dritën e këtij raporti, Bordi ftohet të fokusohet në vendimmarrje lidhur me:

- prioritetizimin e investimeve në infrastrukturë (me mbështetje të Qeverisë Qendrore dhe atyre lokale, si dhe zhvillim të të rinjve;
- mbështetjen e qëndrueshme financiare për basketbollin e vajzave;
- reformimin e mëtejshëm të sistemit të garave dhe kalendarit;
- forcimin e kapaciteteve menaxheriale në nivel klubesh;
- mbështetjen institucionale për zbatimin e Strategjisë 3x3 drejt Prishtina 2030.

Ky seksion synon të shërbejë si pikë reference për diskutim dhe vendimmarrje strategjike të Bordit të FBK-së në fazën e ardhshme zhvillimore.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës



ELVIRA DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës